



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 95, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-068 dhe me Ligjin Nr. 05/L-092, të nenit 3, paragrafit 1. të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për zbatimin e Procedurave Lëndore të Prokurimit Publik, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Lista e Artikujve për Përdorim të Përbashkët, që janë Objekt i Procedurës Qendrore të Prokurimit Publik, e bashkëngjitur në Shtojcën e këtij Vendimi.
2. Obligohet Agjencia Qendrore e Prokurimit dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të bëjnë shpalljen e këtij vendimi, sipas nenit 95, paragrafit 2, të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.
3. Obligohet Agjencia Qendrore e Prokurimit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Shtojcë

Tab. 1. Lista me artikujt për përdorim të përbashkët

Përshkrimi i artikullit	Lloji i kontratës	Kohëzgjatja
1. Furnizim me letër për kopje;	Kontratë Kornizë	2 Vite
2. Furnizim me material zyrtar	Marrëveshje Kornizë	3 Vite
3. Furnizim me vetura të udhëtarëve	Kontratë Kornizë	1 Vit
4. Furnizim me artikuj ushqimor	Kontratë Kornizë	1 Vit
5. Furnizim me mobile	Marrëveshje Kornizë	3 Vite
6. Furnizim me pajisje të teknologjisë informative (Marrëveshje kornizë)	Marrëveshje kornizë	3 Vite
7. Furnizim me pemë dhe perime (Marrëveshje kornizë)	Marrëveshje kornizë	3 Vite
8. Veturat me qira	Kontratë Publike Afatgjate	5 Vite
9. Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi – me qira	Kontratë Publike Afatgjate	3 Vite
10. Furnizim me karburante	Kontratë Kornizë	1 Vit
11. Furnizim me mazut	Kontratë Kornizë	2 Vite
12. Furnizim me ujë të pijes	Kontratë Kornizë	3 Vite